# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437437**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “S’kam folur kurrë me Trump për Zvërnecin”/ Nga projekti te ‘dorëheqja’, Rama: Kur Shqipëria të futet në BE, do shpëtoni nga unë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/11/skam-folur-kurre-me-trump-per-zvernecin-nga-projekti-te-doreheqja-rama-kur-shqiperia-te-futet-ne-be-do-shpetoni-nga-une/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 18:36:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 11 shtator 2026, 18:32:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 11 shtator 2026, 18:31:00 UTC → 11 shtator 2026, 18:33:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2a4c7e4e2eb24296c446bc8eae0bb709be48791d549e4959ba7f361c253cc778` |
| TEKSTI | `5bfb2bebde6023d967d1fa568745c3e17ce7bfaf1e0eca930689b6d23267513f` |
| PAMJA | `3d99de5ea1b9ce83a2051d129bec7a5f29fdcc1d257b70fb8c136a93d22bfa94` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `97088fbda4c5d905aa0b4f45c08cb09daec2c7c21eef86cb78c1aec968f56271` |
| E MËPARSHMJA | `ad0f8cd4a137dbcb6c6b7a82cb483bfdd2ffdd61cbdbf0a6ca451db2da4bb273` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/97088fbda4c5d905aa0b4f45c08cb09daec2c7c21eef86cb78c1aec968f56271`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# “S’kam folur kurrë me Trump për Zvërnecin”/ Nga projekti te ‘dorëheqja’, Rama: Kur Shqipëria të futet në BE, do shpëtoni nga unë

11/09/2026 20:32

Kreu i qeverisë Edi Rama ka treguar se nëse Shqipëria do të futet në BE, ai largohet nga qeverisja.

Në një intervistë me gazetaren Rudina Xhunga në podcastin ‘Flasim’ të Kryeministrit, Rama u shpreh se nuk synon “të bëhet mbret, apo të qeverisë në përjetësi”, por se vijon të jetë në këtë detyrë sepse sipas tij e sheh të hapur derën e BE-së për Shqipërinë.

“Nuk jam këtu për t’u bërë mbret apo për të qeverisur në përjetësi, por jam këtu se shoh derën e hapur të BE-së, kur ta kapërcej pragun e asaj dere ju shpëtoni nga unë”, tha Rama.

I pyetur për pasardhësin ose pasardhësen politike, nëse do jetë mes njerëzve që e sfidojnë apo jo, Rama tha: Ai që të sfidon dhe bëhet pasardhës, ai duhet të të vrasë, pra nuk është dikush që ti e zgjedh.

Duke sjellë edhe një bisedë që ka bërë në 2014 kur takoi për herë të parë Angela Merkelin, Rama tha se ende nuk është hapur ‘gara’ për pasuesin e tij në PS.

Rama shtoi se plani i tij është të largohet nga drejtimi i PS, por jo nga PS.

“Kur vjen momenti i kalimit të stafetës, stafeta kalohet ose duke ikur dhe duke e lënë gjënë në rrjedhje siç unë kam ndërmend ta bëj… Unë nuk do ta lë PS-në, do jem anëtar i organizatës së Surrelit”, u shpreh ai.

“Por ndërkohë po sjell një shembull nga jeta ime politike, kur kam takuar për herë të parë Merkelin, dhe ka qenë takimi i vetëm kur nuk kam fjetur para ditës që ta takoja, se nuk e njihja atë person.

Isha kryeministër, 2014, dhe kisha pasiguri se ajo në TV të krijon idenë e një drejtoreshe shkolle për nxënës me 10… Dhe ndër të tjera më thotë ‘çfarë ndodh me opozitën tënde atje. I thashë është një i ri atje. Çfarë bëhet me atë tjetrin tha, ka ikur? I thashë nuk është më në krye por aty është. Problem tha. Pse i thashë. Tha unë jam shumë mirënjohëse gjithmonë Helmut Holh sepse ai më prodhoi, por në momentin kur u bëra kryetare e partisë ai vazhdoi të rrinte aty dhe vinin njerëzit te unë e pastaj te ai. Dhe një ditë i thashë kjo nuk shkon, tani jam unë, më tha po unë jam këtu për të të ndihmuar. I thashë nuk kam nevojë për ndihmë. Herën tjetër i thashë do më detyrosh… qeshi, tha ‘do ta provosh’, e pastaj gjërat shkuan kështu. Unë tha mendoj se kur vjen dita për të ikur ikën, sepse çdo parti demokratike ku tjetri që vjen konceptohet si pasardhës e ka shumë të vështirë në mos të pamundur që të funksionojë’.

Unë nuk kam ndërmend të zgjedh pasardhës, kështu që pasardhësi ose pasardhësja të dalë dhe të marrë përsipër PS-në. Çështja është që unë ua kam thënë kur ka rënë biseda që mos mendoni se kujt

i vjen radha se nuk është hapur gara, bëjini hysmetin karrierës dhe figurës suaj duke bërë detyrën, kur vjen momenti i kalimit të stafetës, stafeta kalohet ose duke ikur dhe duke e lënë gjënë në rrjedhje siç unë kam ndërmend ta bëj… Unë nuk do ta lë PS-në, do jem anëtar i organizatës së Surrelit, por nuk do largohem nga partia dhe nuk kam ndërmend që t'i ngatërrohem nëpër këmbë kujt do jetë pasues", tha Rama.

Ndërkohë sa i përket projektit të Zvërnecit, i cili është bërë nga vajza dhe dhëndri i Presidentit të SHBA-së, ai tha se nuk ka pasur asnjëherë komunikim për këtë çështje me Donald Trump.

Rama theksoi se nuk do të tërhiqet nga ky investim, por vetëm nëse ligji dhe shkenca, siç thotë ai, do t'ia ndalojnë, atëherë projekti nuk do të realizohet.

"S'kam folur kurrë me Trump për këtë projekt… Nëse do më ndalojë ligji dhe shkenca nuk do bëhet projekti në Zvërnec", tha Rama.

**Top Channel**


Aktualitet »
Operacioni misterioz në Greqi, kush është trafikanti i kokainës që u arrestua dhe kërkohej nga Shqipëria për vrasje?
11/09 19:35
Ishte duke punuar në Marglliç të Patosit, rrëzohet shtylla, humb jetën elektricisti 46-vjeçar
11/09 19:27
"Godisni grupet kriminale", Hita urdhër strukturave të Policisë në Korçë, Tiranë e Dibër: Kapni shtetasit në kërkim
11/09 17:46
Përgjimet e Ron Yefet dhe trafik armësh nga Afrika, ministrja Ismaili i përgjigjet denoncimeve të Ahmetajt: Më vjen ndot të komentoj deklaratat e të arratisurve nga drejtësia
11/09 17:20
Administrativja zhbllokoi pagat, ironizon Rama: Shqiptarët do u falnin gjysëm rroge gjykatësve, po të kishin të njëjtin standard për hallet e tyre
11/09 16:12
Kishte shkuar për të kontrolluar makinën/ Plagoset me kaçavidë i riu në Durrës, shpallet në kërkim autori
11/09 16:04
Na ndiqni:
Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel
Video »
Top News – Si e vdiq mjeku këngëtarin e famshëm grek? E dëndi me injeksione, dëshmon taksisti
Top News-Hyjnesha e Butrintit kthehet në shtëpi, vepra shekullore tani mund të shihet nga vizitorët
Top Channel/ "Nuk e harrojmë kurrë 11 shtatorin"! Trump: Kjo është arseja pse luftojmë sot
Top News – 'Bota do shohë 11 Shtatorin e dytë'/ Kreu i MI5 ngre alarmin: Terrorizmi, kërcënim
Top Channel/ "Teli me gjemba ishte shfaqje e shëmtuar e kompanisë", Rama: S'do ketë më
Top Channel/ Dështon sërish konstituimi i Kuvendit, Kurti përplaset me opozitën
Kryesore
Deputetët e PS Braçe, Spiropali, Xhafaj edhe këtë të premte asnjë njoftim për angazhim në 'Praninë Besnike'
18:24
Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri
10:19
Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe shpallet zyrtarisht i zhdukur
11:38
Rriten tensionet për Ishujt Falkland, presidenti i Argjentinës anulon vizitën në Mbretërinë e Bashkuar
09:28
Lëvizja surprizë e Dinamos, merr ish-lojtarin e Partizanit, firmos sot para derbit të nesërm
16:05
Më të lexuarat
Kryeministri Rama liron nga detyra ministrin e Brendshëm, Besfort Lamallari, Ervin Demo merr postin e tij
Prishet moti/ Rikthehen reshjet e shiut dhe shtrëngatat, si parashikohen temperaturat për fundjavën dhe ditët në vijim
Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri
Profil/ Zëvendëson Lamallarin si ministër i Brendshëm. Nga bashkia e Beratit në Pushtetin Vendor, kush është Ervin Demo
Detaje tronditëse nga vdekja e papritur e Mazonakis/ Pasi u 'ngeli në dorë', mjekët kërkonin në ChatGPT si ta rikthenin në jetë, i bënë edhe foto
Pas betimit si ministre, Spahiu ndan detyrat te Shëndetësia: Që nga nesër në orën 08:00 do hapet një zyrë për problemet e qytetarëve
Administrativja zhbllokoi pagat, ironizon Rama: Shqiptarët do u falnin gjysëm rroge gjykatësve, po të kishin të njëjtin standard për hallet e tyre
Pas mbledhjes së qeverisë, ministrat zbardhin vendimet: 110 mln euro me Gjermaninë, 7 mijë apartamente dhe fond për energjinë
Tensionet përshkallëzohen në Lindjen e Mesme, SHBA dërgon trupa në Arabinë Saudite për luftën kundër Houthive
Vila e sekuestruar në Palasë/ Anila Hoxha zbardh dosjen në Shqipëria Live: SPAK thotë se i përket Ballukut, emaili që çoi hetuesit te pasuria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.